Project co-financed by the European Regional Development Fund

Gazeta #1 | Shtator 2017

Projekti -ENERJ

ENERJ (Projekt i Përbashkët për Efiçensën e Energjisë) është një projekt i Interreg MED dhe synon të zgjerojë dhe përmirësojë koordinimin e Planeve të Veprimit të Energjisë së Qëndrueshme (SEAP) dhe planeve të tjera lidhur me Efiçensën e Energjisë, me qëllim kursimin e energjisë dhe arritjen e objektivave kombëtare për efiçensën e energjisë në ndërtesat publike. Projekti do të zhvillojë dhe testojë një metodologji të orientuar teknologjikisht, që fokusohet në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike përmes Veprimeve të Përbashkëta.

Çfarë po bëjmë në këtë fazë fillestare?

ENERJ u krijua në Janar të vitit 2017, në Romë. Që atëherë partnerët kanë punuar për të ngritur themelet e punës tonë të përbashkët. Në objektin e punës bën pjesë "testimi" dhe përzgjedhja e ndërtesave që mund t'i nënshtrohen përmirësimit të efiçensës së energjisë. Partnerët që ne po flasim janë një grup ndërtesash, si p.sh. ndërtesa e Bashkisë së qytetit, ndërtesat e administratës, shkollat dhe kopshtet. Të dhënat e mbledhura për energjinë do të futen në një platformë web-i në internet. Ndërveprimi me aktorët (administratat publike, ESCO-t, kompanitë e ndërtimit, ekspertët, etj.) është pjesë thelbësore e ENERJ-it. Në raundin e parë të konferencave lokale partnerët informuan palët e interesuara për ENERJ, gjithashtu, u mblodhën rezutatet e tyre në projektet e planifikuara, veprimet e përbashkëta të mundshme, barrierat dhe pengesat, por edhe mundësitë për më të vazhduar më tej.

Agjencia Sllovene e Energjisë GOLEA, më 13 Prill organizoi konferencën e parë lokale dhe paraqiti ENERJ në konsorciumin e Agjencive Sllovene të Energjisë.

Pse duhet ta ndiqni ENERJ?

Ju duhet të ndiqni ENERJ nëse efiçensa e energjisë në ndërtesa është një çështje me me rëndësi për ju dhe nëse ju do donit të dini më shumë rreth financimit dhe zbatimit të përbashkët. Projekti përqëndrohet në ndërtesat publike dhe ka qëllim ambicioz lehtësimin në shkallë të gjerë të veprimeve të përbashkëta për efiçensën e energjisë.

Një instrument i rëndësishëm do të jetë një platformë web-i ku do të informoheni për punën e vazhdueshme në realizimin e këtij projekti.

Projekti modular ENERJ është pjesë e projektit gjithëpërfshirës MEDNICE

Programi i MED-së për periudhën e programuar 2014-2020 ka miratuar një qasje të re, që ka te beje më shumë me identitetin e projektit dhe rezultatet e pritura dhe më pak me procesin apo rezultatet e thjeshta.

Çdo projekt është pjesë e një komuniteti tematik, ENERJ së bashku me 9 projekte të tjera (CESBO MEO, EDU FOOTPRINT, IMPULSE, NEW FINANCE, SHERPA, SISMA, STEPPING, PrioritEE, TEESCHOOLS) formon Komunitetin Tematik të "Ndërtesave Efiçente".

Projekti horizontal MEDNICE është aktiv në krijimin dhe shfrytëzimin e sinergjive midis projekteve modulare. Kjo qasje e re është shumë e rëndësishme për fushën e efiçensës së energjisë, një fushë me veprimtari të shumëllojshme e që kërkon ndryshime të thella në kulturën dhe mentalitetin profesional. ENERJ do t'i kushtojë vëmendje të veçantë jo vetëm bashkëpunimit brenda komunitetit të tij tematik, por edhe bashkëpunimit më të gjerë me grupe projektesh që punojnë në fushën e efiçensës së energjisë në ndërtesa.

Joint Actions for Energy Efficiency

Francë - Pjesëmarrësit e ENERJ në takimin e parë të MEDNICE

Më 7 dhe 8 Mars 2017, konsorciumi MEDNICE, i përbërë nga Euromed Cities Network (udhëheqës), Qytetet e Energjisë, EMUNI, IREC, CMCC dhe Rajoni i Egjeut Verior ftoi në Nicë dhjetë projektet modulare në takimin e parë të saj , i cili ishte, gjithashtu, rasti për të mbledhur Komunitetin Tematik të "Ndërtesave Efiçente". Në arkitekturën e re të MED-së projektet modulare janë niveli i parë, komunitetet tematike niveli i dytë dhe programi i MED-së si tërësi në nivelin e tretë. Në kënvështimin e qeverisjes me shumë nivele kjo gjë nuk duhet parë në sensin e hierarkisë, por në sensin që të tre nivelet janë të ndërlidhura ngushtë dhe plotësojnë njëra tjetrën. Takimi në Nicë ishte një mundësi e çmuar për të përfshirë projekte të tjera të Komunitetit dhe për të kuptuar më mirë se cili mund të jetë kontributi i veçantë i secilit prej nesh në temën e ditës, atë të Efiçiencës së Energjisë në ndërtesat publike.

MEDNICE ka hartuar dhjetë projekte sipas tre temave, "Financimi", "Mjete/strategji" dhe "Ndërtesat shkollore". Një numër mbresëlënës prej 136 partnerësh janë përfshirë në të gjitha projektet së bashku, shumë prej tyre në më shumë se një projekt dhe është një perspektivë emocionuese për t'i ndjekur të gjitha këto projekte në muajt dhe vitet e ardhshëm.

Greqi – Takim me Bashkitë

Më 22 Shkurt 2017 Anatoliki ftoi përfaqësuesit e shërbimeve teknike të katër Bashkive të zonës më të madhe të Selanikut (Thermi, Thermaikos, Pylaia - Hortiatis dhe Kalamaria) për të diskutuar mbi auditimet e energjisë të parashikuara si pjesë e projektit ENERJ. Pas prezantimit të projektit ENERJ dhe objektivave të tij, diskutimi u përqendrua në rezultatet e pritshme të auditimeve energjetike ku Bashkitë paraqitën në këte rast edhe ndërtesat që do të auditoheshin. Diskutimi u fokusua në tipologjinë e ndërtesave më të përshtatshme për përmirësimin e efiçensës së energjisë dhe disponueshmërinë e të dhënave. Bashkitë ranë dakord të japin në kohën e duhur një listë të ndërtesave të mundshme për auditimet e energjisë.

Slovenia - Konferenca e parë lokale

Agjencia Sllovene e Energjisë GOLEA bëri prezantimin e ENERJ në konferencën e parë lokale më 29 Mars dhe në 13 Prill në seminarin e organizuar me Agjencitë Sllovene të Energjisë . Titulli i konferencës lokale ishte "Permiresimi i efiçensës se energjisë në ndërtesat publike", në të cilën prezantuan Vanja Cenciç, menaxhere e projektit të ENERJ në Agjencinë GOLEA, Rajko Leban, drejtor i Agjencisë GOLEA, Matjaž Ribaš, përfaqësues i Banka SID, Bogdan Božac, drejtor i kompanisë "Marles", prodhuesi më i vjetër dhe më i madh slloven i ndërtesave të parafabrikuara, si dhe Nejc Božič, ekspert teknik i projektit ENERJ në Agjencinë GOLEA, Hinko Šolic, drejtor i fondit ECO dhe Martina Gračner, drejtuese e projektit për permiresimin e efiçensës së energjisë të objekteve të Ministrisë së Infrastrukturës.

Evente të tjera

17 Maj, Alicante – Eventi i komunitetit të ndërtimit "Ne jemi MED"

Më 17 Maj në Alicante do të zhvillohet evenimenti i ndërtimit të bashkësisë "Ne jemi MED", e cila do të bashkojë projektet horizontale të 8 komuniteteve tematike të Interreg MED dhe partnerët kryesorë të projekteve modulare. Qëllimi i tij do të jetë puna me një metodologji të përbashkët, duke ndarë idetë, zgjidhjet dhe praktikat më të mira dhe, natyrisht, për të forcuar frymën e komunitetit. [më shumë informacion...]

31 Maj – 1 Qershor, Seville – takimi i 2-të i projektit

Takimi i dytë i projektit të ENERJ do të mbahet në Sevilje nga data 31 maj deri më 1 Qershor. Ky takim do të jetë një rast i mirë për të ndarë eksperiencën mbi aktivitetet për paketat e punës "Testimi" dhe "Transferimi", dhe për të diskutuar mbi të gjitha përmiresimet ndërtesave që eshte subjekti kryesor: të dhënat e nevojshme dhe të dhënat në dispozicion. Partneri ynë kryesor, Anatoliki, do të raportojë për zhvillimin e mëtejshëm të metodologjisë së punës për komunitetet tematike që u diskutuan në Alicante, për të forcuar në këtë mënyrë komunitetin tonë "Ndërtesat Efiçente".

2 Qershor, Seville –Java e Gjelbër – Përcjellja e një praktike të mirë

Jemi shumë të kënaqur që është pranuar nga Komisioni propozimi i partnerit tonë FAMP (Federata Andaluziane e Bashkive dhe Provincave) për eventin e ENERJ në kontekstin e Javës së Gjelbër të BE. Ky event do të shërbejë si një mundësi e mirë për të diskutuar me palët lokale të interesuara, pikëpamjet dhe pritshmëritë e tyre për atë që ENERJ mund të bëjë për ta. [më shumë informacion...]

Grupi i partnerëve

Anatoliki S.A. - Development Agency of Eastern Thessaloniki's Local Authorities (EL)	Andalusian Federation of Municipalities and Provinces (ES)	Istrian Regional Energy Agency L.t.d. (HR)

Cyprus Energy Agency (CY)	Gozo Development Agency – Gozo Regional Committee (MT)	Metropolitan City of Capital Rome (IT)	Goriška Local Energy Agency (SI)
Albania Ministry of Energy and Industry (AL)	Regional Energy and Environment Agency from North Alentejo (PT)	Climate Alliance Italy (IT)	Intermunicipal Community of High Alentejo (PT)

ENERJ mbështetet nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) nën Programin Interreg MED.

ENERJ (Veprimet e Përbashkëta për Efiçensën e Energjisë) mbështet qytetet dhe zonat rurale në zbatimin e veprimeve për efiçensën e energjisë në ndërtesat e tyre si pjesë e politikës së tyre lokale të energjisë dhe klimës. Ajo nxit bashkëpunimin midis qeverive lokale për Veprime të Përbashkëta. Një platformë web-i i ENERJ lehtëson hartimin e veprimeve të përbashkëta dhe përmban bazën e të dhënave për Planet Lokale të Veprimit të Energjisë dhe masat për Efiçiencën e Energjisë.

Projekti i ENERJ ka filluar nga Nëntori i vitit 2016 dhe do të vazhdojë deri në Prill 2019 me një buxhet total prej 2.26 million Euro. Fondet e EU-së janë 1.92 million Euro.

Partneri kryesor: ANATOLIKI S.A. - Agjencia e Zhvillimit të Autoriteteve Lokale të Selanikut Lindor email: reacm@anatoliki.gr / tel. +30 231 0463930